



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 1384/5 Prot

Tiranë, më 26.5.2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

SUBJEKTIT “BINBIN ALBANIA MOBILITY”, NIPT M32321029M

Adresa: Rruga "Shkëlqim Fusha", Pallati "Rreli", Pasuria Nr. 104/8-G9, Zona Kadastrale 3292,
Vol. 34, Faqe 85, Selite, Kodi Postar 1001, Tiranë

TIRANË

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, *ndaj subjektit “BINBIN ALBANIA MOBILITY”, me Nipt M32321029M, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-000857-5, datë 03.03.2026, me të cilin është vendosur masa administrative gjobë, në vlerën 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë.*

Pas marrjes dijëni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë **Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm**, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin në Punë”, i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

“1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t’u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji.”

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit** Nr.ISHPSHSH-TR-2026-000857-5, datë 03.03.2026, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është **shndërruar në titull ekzekutiv** dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

“Gjoha dhe shumata që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv.”

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet **brenda 10 (dhjetë) ditëve**. Bashkëlidhur gjeni **faturën për arkëtimin e gjobës**. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni **mandatin e arkëtitimit** në adresën elektronike: **info@slj.gov.al**.

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijojë me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTORI

Eljo Muçaj

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp is partially obscured by the signature but contains the word "TIRANË" at the bottom. The signature is fluid and cursive, extending from the left side of the stamp towards the right.

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 109

Datë 25.05.2026

BANKËS _____ Llogaria e te Ardhurave

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientët (persona, persona fizikë, persona juridikë), arkëtime për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode, numer identifikimi dhe shuma si më poshtë

Emri Institucionit përfitues

ISHPSHSH
Drejtoria Qëndrore Tiranë

Kodi Institucionit Përfitues

1004210

Kodi Degës së Thesarit ku vepron

3535

Emri i paguesit (persona/persona fizik/person juridik)

Binbin Albania Mobility

Numri identifikimit të paguesit

M32321029M

PËRSHKRIMI I TË ARDHURAVE			SHUMA
ID	Emertimi	Kodi Ilog.Ekonomike	ARKETUAR
Detyrimi			Leke
1	NR.ISHPSHSH-TR-2026-000857-5 date 03.03.2026	7115499	1,400,000
	Nje milion e katerqind mije leke		
	TOTALI		1,400,000

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË
Eljo Muçaj

Binbin Albania Mobility

Shënim: Për Bankat e Nivelit të Dytë

Në zbatim të nenit 30, ligji 10279 datë 25.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", fatura për arkëtim është e vlefshme për pagesë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj. Në të kundërt anulohet.